



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-125
Prishtinë, më 29 tetor 2010, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 29 TETOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Naim Maloku, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Slllobodan Petroviq dhe Numan Baliq, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Xhezair Murati dhe Branislav Grbiq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi.

Nga Zyra e Presidentit: Lumnije Murati,
Nga ZCN: Blerta Bejtullahu dhe
Nga OSBE, Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjet plenare të radhës

Kryesia shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç dhe me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që mbledhjet e Kuvendit të mbahen më 29 tetor 2010 dhe më 2 nëntor 2010:

Më 29 tetor 2010, me këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Më 02 nëntor 2010, me këtë

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, i G/P të AKR-së, në mbështetje të 40 deputetëve.

Kryesia, pasi shqyrtoi **propozimin për procedim me** Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për të drejtat e ish të burgosurve politikë dhe Raportin e Organit të Pavarur Përzgjedhës lidhur me emërimin e një anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, vendosi që këto dy pika të radhiten në një të njërit prej mbledhjeve plenare të radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 10:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale